



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1483 Prot.

Gjirokastër, më 08 / 11 / 2019

V E N D I M

Nr. 25 , datë 08 . 11 . 2019

**MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
"MASTER I SHKENCAVE " NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E
MACERATËS – ITALI "ARKEOLOGJI, HISTORI DHE ADMINISTRIM I PASURIVE
KULTURORE - ASPIC"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë " neni 38 pika 1 / dh, udhëzimit nr. 31 , datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë ", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 14 pika 6 dhe pika 9 si dhe vendimit të njësisë kryesore nr. 05 , datë 24.10.2019, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej në mbledhje e tij të datës, 08. 11. 2019,

V E N D O S I :

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët në bashkëpunim me universitetin e Maceratës – Itali "Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore - ASPIC".
2. Ky program studimi do të realizohen të 2 (dy) vite akademik me 120 ECST në sistemin me kohë të plotë.

3. Në përfundim të studimeve do të lëshohet diplomë e dyfishtë :
 - a. Diplomë Universitare me titull “ Administrim i pasurive kulturore historike dhe arkeologjike” nga Universiteti “ Eqrem Çabej ” Gjirokastër.
 - b. Diplomë Universitare me titull “ Kërkime historike dhe burime të kujtesës” nga Universiteti i Maceratës – Itali

4. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për zbatim!

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof. dr Bektash MEMA

